



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 40/4

Shprehur: 17.11.22

V E N D I M

Nr. 117/11, datë, 17. 11. 2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Lorena Musai, dëgjoi pretendimet e saj dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.892/2 ex 21 datë 23.09.2022, “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Lorena Musai”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numer protokollit 40, datë 23.09.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36. pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.117, datë 07.10.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Lorena Musai, për kryerjen e shkeljeve disiplinore në formën :

“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”,

parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, **neni 33, pika 2, gërma “a”** e këtij ligji

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Lorena Musai, gjatë hetimit të 10 proçedimeve penale, konkretisht:

procedimi penal **nr.2021**, datë 08.10.2019, procedimi penal **nr. 1424**, datë 22.07.2019 ,
procedimi penal **nr.1305**, datë 30.08.2020, procedimi penal **nr.1099**, datë 10.07.2020,
procedimi penal **nr.2003**, datë 25.11.2020, procedimi penal **nr.2037**, datë 07.11.2018,
procedimi penal **nr.295**, datë 12.02.2019, procedimi penal **nr.2576**, datë 31.12.2019,
procedimi penal **nr.910**, datë 09.05.2019, procedimi penal **nr.1349**, datë 09.09.2020.

Nga aktet që u administruan gjatë seances dëgjimore per procedimin disiplinor, u provua se:

2.1 Prokuroria e Përgjithshme, mbi bazën e Urdhërit Nr.61 datë 02.06.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ushtruar kontroll mbi treguesi e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vitin 2021.

Objekti i kontrollit ishte ligjshmëria e veprimeve hetimore të oficerëve të Policisë Gjyqësore në;

- Procedimet penale të regjistruara nga data 01.05.2020 – 31.05.2021, dhe ato të mbartura nga vitit 2019, për të cilat është vendosur pushimi i procedimit penal, janë dërguar për gjykim, apo nuk kanë përfunduar hetimet dhe janë mbartur për vitin 2021.

- Mosfillimet e procedimeve penale të vendosura për materialet kallëzuese/referuese të regjistruara prej datës 01.05.2020 – 31.05.2021.

- Disiplina në punë.

Nga ana e grupit të punës në përfundim të procesit të kontrollit të ushtruar për cdo oficer të policisë gjyqësore, është përpiluar raporti përfundimtar përmbledhës në të cilan janë pasqyruar problematikat si në nivel organizativ të punës së seksionit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ashtu dhe në nivel individual për secilin oficer të policisë gjyqësore.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar për periudhën objekt inspektimi u konstatua se ne hetimin e procedimeve penale të hetuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lorena Musai u konstatua se në disa procedime penale janë lejuar zvarritje në hetim dhe nuk janë respektuar afatet e caktuara në urdhërin e delegimit të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore.

Zvarritjet e veprimeve hetimore janë të pajustificuara dhe në shkelje të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat rregullojnë dhe disiplinojnë hetimin dhe afatet e tij.

2.2. Në datën 22.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1424**, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policies së rendit publik, parashikuar nga neni 236/1 i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 18.05.2020.

Gjatë hetimit të këtij procedimi penal, konstatohen zvarritje të pajustificuara në kryerjen e veprimeve hetimore, dhe distance e madhe kohë midis veprimeve hetimore që kanë bërë me pyetjen e dëshmitarëve dhe administrim të dhënave shkresore.

Prokurori i çështjes , në datën 22.07.2019 ka nxjerë urdhër për kryerje të veprimeve hetimore, duke ngarkuar me hetimin e çështjes oficerin e policisë gjyqësore Lorena Musai dhe i ka caktuar si afat përfundimtar për kryerjen e veprimeve hetimore, datën 25.08.2019. Nga aktet e dosjes ka rezultuar nuk është repsktuar ky afat. Proçedimi penal është regjistruar në datën 22.07.2019, ndërsa relacioni përfundimtar i përgatitur nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lorena Musai, mban datën 10.03.2020.

Pretendimi i oficeres së Policisë Gjyqësore Lorena Musai, se nuk janë lejuar zvaritje të hetimit dhe se nga prokurori i çështjes i është ngarkuar kryerja e nje veprimi të vetëm, të cilin e ka realizuar brenda afatit, nuk qëndron dhe nuk mbështetet me prova. Nga përmbajtja e urdhërit të prokurorit, për kryerjen e veprimeve hetimore, rezulton se i janë ngarkuar kryerja e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore për sqarimin e çështjes.

Nga aktete e administruara për këtë proçedim penal, u provua se veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Lorena Musai, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe proçedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 10 muaj.

2.3. Në datën 30.08.2020 është regjistruar **proçedimi penal nr.1305**, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 14.12.2020.

Gjatë hetimit të proçedimit penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musaj, janë lejuar zvarritje te theksuara dhe të pajustificuara. Prokurori i çështjes , në datën 30.08.2020 ka nxjerë urdhërin për kryerje të veprimeve hetimore, duke ngarkuar me hetimin e çështjes oficerin e policisë gjyqësore Lorena Musai dhe i ka caktuar si afat përfundimtar për kryerjen e veprimeve hetimore, datën 30.10.2020. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se, nga momenti i regjistrimit të proçedimit penal dhe nxjerrjes të urdhërit për kryerjen e veprimeve hetimore, 30.08.2020 deri më datë 04.12.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Veprimi i pare hetimor nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lorena Musaj është kryer në datën 04.12.2020, kur ka pyetur personin nën hetim.

Edhe për këtë proçedim penal, u provua se veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Lorena Musai, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe proçedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 4 muaj.

2.4. Në datën 10.07.2020 është regjistruar **proçedimi penal nr.1099**, për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit, dërguar për pushim në datën 18.05.2021.

Gjatë hetimit të proçedimit penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musaj, janë lejuar zvarritje te theksuara dhe të pajustificuara. Prokurori i çështjes , në datën 10.07.2020 ka nxjerë urdhërin për kryerje të veprimeve hetimore, duke ngarkuar me hetimin e çështjes oficerin e policisë gjyqësore Lorena Musai dhe i ka caktuar si afat përfundimtar për kryerjen e veprimeve hetimore, datën 15.09.2020. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musaj, janë kryer disa veprime në muajin shtator 2020 dhe më pas, nga data 30.09.2020 deri në datën 29. 04.2021, dosja është mbajtur në dorë pa kryer asnjë veprim hetimor.

Veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Lorena Musai, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe proçedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 6 muaj.

2.5. Në datën 25.11.2020 është regjistruar **proçedimi penal nr.2003**, për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, kërkuar pushimi i proçedimit, datë 23.04.2021.

Gjatë hetimit të proçedimit penal, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musaj, janë lejuar zvarritje të pajustificuara që konsistojnë në mosvijueshmërinë e veprimeve hetimore dhe kryerje të veprimeve hetimore jashtë afatit të caktuar nga prokurori i çështjes. Prokurori i çështjes, në datën 24.11.2020 ka nxjerë urdhërin për kryerje të veprimeve hetimore, duke ngarkuar me hetimin e çështjes oficerin e policisë gjyqësore Lorena Musai dhe i ka caktuar si afat përfundimtar për kryerjen e veprimeve hetimore, datën 24.02.2021. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musaj, janë kryer disa veprime në muajin nëntor 2020. Mandej në muajin dhjetor 2020 nuk është kryer ndonjë veprim hetimor me përjashtim të dy shkresave dërguar Komisarariatit të Policisë Elbasan dhe Gjykatës Elbasan. Janë kryer dy veprime hetimore në muajin janar 2021, marrje e të dhënave nga persona që kanë dijeni për ngjarjen dhe më pas nga data 15.01.2021 deri në datën 01.03.2021 nuk është kryer ndonjë veprim hetimor.

Megjithëse, nisur nga natyra e çështjes (përndjekja) dhe pasojat e pakthyeshme që këto lloj veprash penale sjellin, kërkohej një hetim i shpejtë dhe përfundimi i veprimeve hetimore në një kohë sa më të shkurtër. Në kundërshtim më afatet e lena nga prokurori, nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore, janë lejuar zvarritje dhe diferenca në periudha të gjata kohe nga një veprim hetimor në tjetrin. Nuk mund të justifikohet mbajtja e dosjes pa veprime me argumentin se priteshin përgjigjet për shkresat dërguar Komisarariatit të Policisë Elbasan dhe Gjykatës Elbasan, në një kohë që kishin kaluar 3 muaj nga dërgimi i tyre.

Veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Lorena Musai, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe proçedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 5 muaj.

2.6 Në datën 07.11.2018 është regjistruar **proçedimi penal nr.2037**, për veprën penale “Shkatërimi i pronës me zjarr, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, kërkuar pushimi i proçedimit penal në datën 18.02.2021.

Konstatohen zvarritje të gjata dhe të pajustificuara gjatë hetimit të proçedimit penal. Prokurori i çështjes, në datën 07.11.2018 ka nxjerë urdhërin për kryerje të veprimeve hetimore, duke ngarkuar me hetimin e çështjes oficerin e policisë gjyqësore Lorena Musai dhe i ka caktuar si afat përfundimtar për kryerjen e veprimeve hetimore, datën 05.02.2019. Në shkelje të këtij afati, për afro 6 muaj nga data 22.01.2019 kur është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit piro – teknik, deri në datën 24.07.2020 nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Në këtë datë është përpiluar shkresa dërguar MNZSH-së, Bashkia Cërrik”. Dosja është mbajtur në hetim nga oficeri i Policisë Gjyqësore për afro 1 vit e 7 muaj. Në total proçedimi penal është mbajtur në hetim për 2 vjet e

3 muaj, deri në datën 18.02.2021, datë në të cilën është përpiluar njoftimi për përfundimin e hetimeve.

2.7 Në datën 12.02.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr.295**, për veprën penale “Ndërtimi I paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K.Penal, dërguar gjyqit në datën 15.06.2020.

Konstatohet se gjatë hetimit janë lejuar zvarritje të gjata dhe të pajustificuara. Hetimi për këtë proçedim penal ka zgjatur për 1 vit e 3 muaj. Ka periudha të gjata kohore pa u kryer asnjë veprim hetimor dhe distance kohore nga njëri veprim hetimor në tjetrin.

Nga momenti i administrimit të aktit të ekspertimit teknik datë 15.07.2019 deri më datë 07.11.2019, datë kur është i është dërguar njoftim shtetasit Zybe Bogdani për t’u pyetur në cilësinë e personit nën hetim, nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor, duke zvarritur hetimin për afro 4 muaj.

Është neglizhuar thirrja dhe paraqitja e shtetates Zybe Bogdani për t’i komunikuar akuzën dhe pyetur si i pandehur, veprim i cili është realizuar më datë 05.06.2020. Kanë kaluar afro 11 muaj nga momenti i administrimit të aktit të ekspertimit teknik, që oficeri I Policisë Gjyqësore, te kryej veprimin procedural të komunikimit të akuzës, pyetjes si i pandehur dhe njohjen me përfundimin e hetimeve.

2.8 Në datën 31.12.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr.2576**, për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 28.12.2020.

Konstatohet se gjatë hetimit janë lejuar zvarritje të gjata dhe të pajustificuara. Hetimi për këtë proçedim penal ka zgjatur për afro një vit. Ka periudha të gjata kohore pa u kryer asnjë veprim hetimor dhe distance kohore nga njëri veprim hetimor në tjetrin.

Nga momenti i regjistrimit të proçedimit penal datë 31.12.2019 deri më datë 10.12.2020, datë kur është përpiluar relacioni përfundimtar nga oficeri i Policisë Gjyqësore, janë kryer shumë pak veprime hetimore, është marrë një deklaram nga kallëzuesja, është administruar akt ekspertimi mjeko-ligjor, është administruar çertifikata e gjëndjes gjyqësore dhe mandej nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor, duke zvarritur hetimin për afro 1 vit. Veprimet e pakta hetimore të kryera për këtë proçedim penal, nuk justifikojnë mbajtjen kaq gjatë të dosjes në hetim, për më tepër që në rastin konkret ndodhemi para një vepre penale për të cilën kërkohet hetim i shpejtë, për të mënjeluar pasojat e rënda që ajo sjell.

2.9 Në datën 09.05.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr 910**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 21.09.2020.

Gjatë hetimit të këtij proçedimi penal janë lejuar zvarritje të gjata dhe të pajustificuara të hetimit. Hetimi për këtë proçedim penal ka zgjatur për afro 1 vit e 4 muaj. Për gati një vit, kur oficerja e Policisë Gjyqësore Lorena Musai është caktuar të zëvendësojë në këtë proçedim penal oficerin e Policisë Gjyqësore Artan Lika, dosja është mbajtur prej saj pa u kryer asnjë veprim hetimor. Nga aktet e dosjes rezulton se në datën 24.07.2019 është marrë vendimi për

kryerjen e ekspertimit teknik, akt i cili është dorëzuar nga eksperti në datën 29.05.2020. dhe gjatë kësaj periudhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Në kundërshtim me sa pretendon oficerja e Policisë Gjyqësore, Lorena Musai, ka patur detyrimin që të kërkonte nga eksperti kryerjen e aktekspertimit dhe për çdo vonesë të tij të njoftonte prokurorin e çështjes.

2.10. Në datën 09.09.2020 është regjistruar **procedimi penal nr. 1349**, për veprat penale “Dhuna në familje” dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, parashikuar nga nenet 130/a/4, dhe 321/2 të Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 30.03.2021.

Edhe në këtë procedim penal janë lejuar zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në moskryerjen në vijueshmëri të veprimtarisë hetimore. Prokurori i çështjes, në datën 09.09.2020 ka nxjerë urdhërin për kryerje të veprimeve hetimore, duke ngarkuar me hetimin e çështjes oficerin e policisë gjyqësore Lorena Musai dhe i ka caktuar si afat përfundimtar për kryerjen e veprimeve hetimore, datën 09.11.2020. Në shkelje të këtij afati, hetimi i procedimit penal ka zgjatur pa shkak të arsyeshëm për afro 6 muaj. Konstatohet se nga momenti i regjistrimit të procedimit penal dhe leshimit të urdhërit të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore, 09.09.2020 deri në datën 26.11.2020 nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Lorena Musai, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe procedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 5 muaj.

2.11 Lidhur me procedimin penal **nr.2021/2019**, regjistruar për veprën penale “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”, parashikuar nga neni 293 i K.Penal, pushuar në datën 28.07.202, i cili përfshihet në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në grupin e procedimeve penale për të cilat kërkohet procedimi disiplinor, Komisioni nuk konstaton zvarritje në hetimin e këtyre procedimeve penale, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musai.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, pas administrimit të provave të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lorena Musai, arriti në përfundimin se në procedimin penal 2021/2019 nuk evidentohen veprime apo moveprime të saj, që pasjellin zvarritje në hetimin e këtij procedimi penal. Për këtë procedim penal oficeres Lorena Musai nga prokurori i është ngarkuar kryerja e një veprimi hetimor, të cilin ajo e ka kryer brenda afatit të caktuar nga prokurori.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shpjegimet e vetë subjektit të procedimit disiplinor, provohet se gjatë hetimit të 9 procedimeve penale, të trajtuara më lartë, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Lorena Musai, janë shkelur kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, që disiplinojnë afatet e hetimit dhe dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorit. Sikurse rezultojnë nga aktet e dosjeve penale të sipërcituara, shumë veprime hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdherin e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 mujor që parashikon neni 323 i KK.Pr.Penale. Neni 323 i K.Pr.Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.”

Ndërsa në nenin 7, pika 2 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, është parashikuar detyrimi që ka oficeri i Policisë Gjyqësore për të zbatuar urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Sikurse u provua gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, për të gjitha proçedimet penale që utrajtuan më sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore Lorena Musai, nuk ka respektuar afatet e hetimit dhe afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e çështjes.

4. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të prokurorit, nga oficeri i policisë gjyqësore Lorena Musai, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, dhe nenit 7 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, mbajtja në dorë e proçedimit penal, pa kryer veprime hetimore dhe kryerja e tyre jashtë afateve të caktuara nga prokurori, përbëjnë shkelje disiplinore në formën, **“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”**, parashikuar nga **neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”**.

Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenit 7, pika 2, oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë detyrimin ligjor të zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Ndërsa në nenin 33, pika 2 e Kodit të Proçedurës Penale parashikohet detyrimi i Policisë Gjyqësore për të kryer detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe të njoftojë atë menjëherë mbi rezultatet e tyre. Për proçedimet penale objekt i shqyrtimit të këtij proçedimi disiplinor, prokurori ka caktuar veprimet hetimore që duhet të kryeshin dhe afatin brenda të cilit duhet të kryeshin nga oficeri i policisë gjyqësore, të cilat nuk janë respektuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Lorena Musai.

Mosrespektimi afateve të caktuara nga prokurori, kryerja e veprimeve hetimore tej këtyre afateve, dhe mosnjoftimi i prokurorit, për rezultatet brenda afatit të caktuar prej tij, përbënë shkelje të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe zvarritje në hetim, në kuptimin që Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” jep për konceptin e zvarritjeve në hetim, të cilat sjellin si pasojë përgjegjësi disiplinore për oficerin e Policisë Gjyqësore.

Në thelb, afatet e hetimit të përcaktuara në Kodin e Proçedurës Penale janë afate për prokurorin. Sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, përgjegjës për hetimin e çështjes është prokurori. Ai ka përgjegjësinë për ecurinë e çështjes dhe përfundimin e saj në afatet që ka caktuar Kodi i Proçedurës Penale.

Oficeri i Policisë Gjyqësore veç parashikimeve të Kodit të Proçedurës Penale, kryesisht lidhet me urdhërat e prokurorit për afatet e hetimit. Prokurori i cakton ato në bazë të një plani që ai ka për hetimin dhe përfundimin e çështjes. Për oficerin e Policisë Gjyqësore, afate të hetimit janë ato që cakton prokurori në urdhërat për kryerjen e veprimeve hetimore.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Lorena Musai, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “a”, pika 2, e nenit 33, parashikon si **shkelje të lehtë**, “*veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje te proçeseve hetimore*”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Lorena Musai, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljes disiplinore të kryera prej saj, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit.

Gjithashtu Komisioni i referohet dispozitave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që, për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Lorena Musai të japë masën disiplinore **“vërejtje me shkrim”**, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me katër vota pro.

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Lorena Musai, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i jepet masa disiplinore ***“Vërejtje me shkrim”***.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Lorena Musai, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Lorena Musai.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR

ARJAN MUÇA

Mungon

ANËTAR

HARI GOGO

Hogo



ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO

Muço